

“KOVID-ARENA” GAZETARESKE:

LUFTA PËR SHËNDETIN DHE PËR
INFORMACIONE TË SAKTA



Prill 2021

SHM

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	3
I. SFIDAT PROFESIONALE TË GAZETARËVE NË PANDEMI	5
1.1. Në vend 30 ditë, mora përgjigje pas shtatë muajve	7
1.2. Duhet të ekzistojë hapësirë për kritika çdoherë	8
1.3. Të punësuarit janë në izolim, do të vonojnë përgjigjet	10
1.4. Raportimit nga kuvendi gjatë kohës së pandemisë- “jo faleminderit”	12
1.5. Për shkak sjelljes joprofesionale ndodhtë që të krijohet panik në mes qytetarëve	13
1.6. Qeveria dhe transparenca gjatë kohës së pandemisë	16
1.7. Rekomandime për transparençë më të madhe	18
II. SI PANDEMIA NDIKOI MBI BOTËN MEDIATIKE “PRAPRA PERDES”	22
2.1. Rekomandime për punë në redaksitë	26
2.2. Trazirat financiare për gazetarët dhe mediat	30
2.3. Mitet për kovid-19 në mënyrë shtesë u krijuan probleme gazetave	32
2.4. Çfarë mësuam nga pandemia?	33
2.5. Rekomandime: vaksinim kundër kovid dhe kundër dezin- formatave?	35

Redaktor: Deniz Sulejman

Autorët: Irena Mullaçka
Miroslava Burns



Ky botim është përgatitur me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian ose Fondit Evropian për Demokraci

PARATHËNIE

Gjatë kohës së pandemisë me koronavirusin, të cilin ende po e jetojmë, gazetarët për herë të parë në historinë e shtetit, ishin të ballafaquar me sfida të reja profesionale. U ballafaquan me një mënyrë krejtësisht të re të punës dhe raportimit, ndërsa nga ana tjetër ishin të ekspozuar ndaj rreziqeve serioze për shëndetin e tyre.

Punëtorët mediatik në fillimin e krizës, ishin më tepër të ekspozuar ndaj infektimit me KOVID-19 për dallim nga personat tjerë, posaçërisht ata të cilët kanë punuar në teren, por nënkuptohet edhe ata në shtëpitë e mëdha mediatike, duke pasur parasysh natyrën e profesionit gazetaresk në radiodifuzerët më të mëdhenj në drejtim të grumbullimit të informacioneve dhe përpunimit të informacioneve në grupe. Në këtë periudhë, mars-qershor 2020, ekzistonte edhe mungesë e pajisjeve shëndetësore, të cilën shumica e mediave nuk kanë mundur vet ta sigurojnë, me çka në mënyrë shtesë rritej rreziku për shëndetin e gazetarëve. Shoqatat profesionale të gazetarëve, më saktësisht Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, në këtë periudhë në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare ka dhuruar mbi 100 pako pajisje mbrojtëse për redaksitë në tërë shtetin, dhe kjo nuk ishte vetëm një ndihmë simbolike. Dorëza, maska, veshje mbrojtëse, pajisje për dezinfektim, syze, ishin vetëm një pjesë e pajisjeve të nevojshme të cilët u ndanë në të gjithë, ose pothuajse në të gjitha redaksitë në vend.

Por pandemia nuk ndalej. Pas shokut fillestar, pasoi adaptimi me kushtet e reja për punë të cilët u bënë “normalja e re” në profesionin gazetaresk. U ndryshua mënyra e sigurimit dhe pasimit të informacioneve, burimet e informacioneve, personat zyrtar dhe jozyrtar në mënyrë të ndryshëm komunikojnë me gazetarët gjatë pandemisë. Shumica e brifingjeve janë nëpërmjet ekranit të kompjuterit ose telefonit celularë, konferencat për shtyp shkojnë online, pa prezencën e gazetarëve, ndërsa opinioni është i etshëm për informacione. Si të gjenden informacionet, a janë burimet zyrtare të vetmit në të cilat duhet të mbështeten gazetarët? Si të vendosemi ndaj dezinformatave? Çfarë të bëjmë kur institucionet nuk kanë përgjigje ndërsa opinioni ka etje për informacione? Pyetje këto për të cilat në vazhdimësi askush nuk kishte përgjigje adekuate.

Çdo informacion në kohë të pandemisë duhej të kontrollohet dhe të filtrohet për shkak rrezikut që në të të hyjë helmi i dezinformacioneve ose gjysmë informacioneve. Narracionet e rrejshme e ndiqnin çdo mundësi të plasojnë dezinformacione dhe, përkaj pandemisë me kovid-19 kishim edhe infodeminë e cila ishte po aq e rrezikshme. Sfidat profesionale të mediave tradicionale por edhe të mediave të reja u gjetën para një testi të ri-si ndaj gënjeshtres të përgjigjen me të vërtetën.

Qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë në këtë periudhë vazhdimisht dilnin me informacione zyrtare në lidhje me numrin e të infektuarve, të vdekurve, për rritjen e të infektuarve në bazë të komunave. Nota e përgjithshme

për transparencën e Qeverisë në atë periudhë mund të vlerësohet si e kënaqshme por mungonin informacione nga brenda vendit, ndërsa filloi të ulet edhe transparencën në fondet, ndërmarrjet publike, agjencitë qeveritare. Fokusi ishte vendosur në betejën kundër kovid-19, por mungonin përgjigje për shumë tema të rëndësishme në shoqëri.

Në mënyrë shtesë, sfidat financiare të mediave ishin dhe janë ende problem, para se gjithash për shkak të hyrave të zvogëluara në mediat, të cilat krijojnë kërcënim për largime dhe uljen e rrogave. Në kushte të krizës shëndetësore, e cila filloi të pasqyrohet edhe mbi shëndetin mental të njerëzve, ky ishte një problem shtesë. Në arenën e tillë për saktësi dhe me kohë, përpos interesit publik, gazetarët dhe punëtorët mediatik u deshën të përkujdesen edhe për shëndetin e tyre, dinjitetin e rrogave dhe paqen psikologjike.

Kriza me kovid-19, sipas hulumtimit të Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGPM), në mënyrë shtesë e ka përkeqësuar edhe ashtu pozitën e dobët socio-ekonomike të gazetarëve dhe ka kontribuar që të ndikojë mbi shëndetin mental të punonjësve mediatik. Sipas hulumtimit të fundit të SPGPM-së, kriza ka ndikuar në shëndetin mental në mbi 62 për qind të gazetarëve, ndërsa 17 për qind prej tyre janë ballafaquar me ulje të rrogës në vitin 2020.

Nga fillimi i pandemisë me kovid-19, e cila filloi pothuajse në të gjitha vendet e botës në shkurt dhe mars 2020-të, shumë njerëz kalojnë më pakë kohë në shoqërim dhe më tepër kohë duke qëndruar në shtëpitë e tyre me aparatet e tyre digjitale. Kjo dukuri në mënyrë shtesë ka krijuar hapësirë, por edhe e ka rritur interesin e qytetarëve të ndjekin informacione, para se gjithash në lidhje me kovid-19, por edhe për tema tjera politike dhe ekonomike si pasojë e pandemisë. Në kushte të krizës globale, gazetarët dhe mediat kanë rol të madh në informimin e qytetarëve si të mbrojnë shëndetin publik.

Ky rol i gazetarëve dhe mediave ishte i njohur edhe në Maqedoni. Supozohet se mediat tradicionale kanë kthyer një pjesë të shikuesëve, me qasjen në përgjithësi profesionale ndaj lajmeve për pandeminë, ndërsa edhe një pjesë e online-mediave treguan virtyt dhe guxim në betejën me narracionet e rrejshme, por edhe në gazetarinë hulumtuese. Edhe pse mund të numërohen ën gishta, disa shkrime hulumtuese arritën që të kapin një pjesë e skenës në të cilën jeton Maqedonia, ndërsa në të kishte indice për përfitime “ushtarake”, vendime të çuditshme, marrëveshje joprincipiale, shkelje të protokolleve. E gjithë kjo ishte nën llupë të gazetarëve, ndërsa një pjesë e tyre edhe njëherë dëshmoi se nuk u mungon guximi për hulumtime edhe në kushte pandemie.

I. SFIDAT PROFESIONALE TË GAZETARËVE NË PANDEMI

Gjatë kohës së pandemisë me virusin kovid-19, gazetarët për herë të parë në historinë e shtetit ishin të ballafaquar me sfida të reja profesionale, gjegjësisht të ballafaqohen me mënyrë të re të punës dhe raportimit, ndërsa nga ana tjetër kjo të jetë rrezik për shëndetin e tyre. Nga shkurti e këndej ata rregullisht ishin të ekspozuar në rrezik në mënyrë që saktë dhe në kohë ta informojnë opinionin dhe të paraqesin fotografi nga tereni, por, sa kalonte koha, një pjesë e institucioneve e harruan fjalën transparencë dhe llogaridhënie.

Shkruan: Irena Mullaçka

Më 26 shkurt 2020, në Maqedoni për herë të parë u paraqit rasti i parë i një personi të infektuar me virusin e rrezikshëm të koronës, të cilin për herë të parë në shtet e solli një grua e cila kishte qenë për vizitë tek familjarët e saj në Itali. Ajo në mënyrë të shpejtë ishte hospitalizuar në Klinikën Infektive dhe që këtu filloi beteja e përditshme me virusin vdekjeprurës, nga i cili deri tani janë sëmurë mbi 100.000 qytetarë, ndërsa kanë vdekur mbi 3.000 pacientë.

Për herë të parë në historinë, shteti u gjend në një situatë të tillë pa rrugëdalje, ku në sipërfaqe dolën të gjitha problemet e grumbulluara në sistemin shëndetësorë, të cilët janë grumbulluar për vite me radhë, si dhe mungesa e kuadrit mjekësor që është determinues në luftën kundër virusit të rrezikshëm. Maqedonia u gjet në një situatë të jashtëzakonshme, për herë të parë në orë polimore, ma kufij të mbyllur si dhe objekte hotelerike. Numri i të sëmurëve dhe të vdekurve dita ditës filloi të rritet, autoritetet shëndetësore në fillim nga dy herë në ditë informonin për zhvillimet alarmante ndërsa qytetarët rregullisht ndiqnin situatën nëpërmjet ekraneve televizive dhe prisnin raportet e reja nga Ministria e Shëndetësisë.

Megjithatë, në tërë këtë krizë me koronavirusin nuk u kursyen as gazetarët të cilët duheshe që në mënyrë normale ta kryejnë detyrën dhe të raportojnë për zhvillimet në shtet, pa dallim nëse kjo ishte nga hapësirat e Qeverisë apo nga ndonjë prej ministrisë. Në fillim gazetarët mund të merrnin pjesë në konferencat për shtyp me pajisje mbrojtëse por më pas u soll vendim për kyçje online, gjë që filloi të ndikojë edhe në transparencën e më tepër institucioneve përgjegjëse.

Gazetarët për herë të parë në historinë e shtetit ishin të

ballafaquar para sfidave të reja, gjegjësisht të ballafaqohen me një mënyrë krejtësisht të re të punës dhe raportimit, ndërsa nga ana tjetër kjo të jetë e rrezikshme për jetën e tyre. Nga shkurti e këndej, ata rregullisht ishin të ekspozuar ndaj rrezikut në mënyrë që në kohë dhe saktë ta informojnë opinionin dhe ta paraqesin fotografinë nga tereni, por, si kalonte koha, një pjesë e institucioneve, disa qëllimisht, disa ndoshta edhe pa qëllim, harruan fjalën transparencë dhe llogaridhënie. Problem shtesë në tërë këtë tregim paraqet edhe ajo që një pjesë e atyre që janë të angazhuar për marrëdhënie me opinionin ndonjëherë arsyeoheshin se të punësuarit e tyre janë “viktimë” e koronavirusit, dhe kështu nuk mund të arrijnë të punojnë më aq numër të vogël të njerëzve, ndërsa këtu ishin edhe rastet ku shumica prej tyre kanë fëmijë nën moshën 10 vjeçare dhe duhej të qëndrojnë në shtëpi dhe të përkujdesen për ta, që ishte një nga rekomandimet e qeverisë gjatë kohës së pandemisë.

Nga përvoja e deritanishme, fakt është se çdo kush i cili vjen në pushtet, më tepër i shkon përshtat që të fsheh problemet me të cilat është ballafaquar shteti, sesa t'i tregoj publikisht, me qëllim që të dëshmojë se transparenca dhe interesi publik është para se gjithash.

Qeveria e tanishme ka ndërmarr disa hapa, të cilat e kanë përmirësuar komunikimin me punëtorët mediatik, të paktën në pjesën e transparencës, për dallim nga më herët, ku një informacion i thjeshtë trajtohej si sekret shtetëror. Komunikimi i përmirësuar edhe pse ekziston, megjithatë, është e qartë se një pjesë e përfaqësuesve të qeverisë, posaçërisht në nivelet më të ultë, bëjnë përpjekje që gjërat t'i fusin nën tepih. Të shohim në tërë situatën se çfarë u nxor si mësim nga pandemia e tmerrshme e koronavirusit.

1.1. NË VEND 30 DITË, MORA PËRGGJIGJE PAS SHTATË MUAJVE

Pas rasteve të para të regjistruara me kovid-19, kah fundi i muajit shkurt dhe pas zbatimit të masave përkufizim të lëvizjes në pjesën e parë të muajit mars, një numër i madh i institucioneve u riorganizuan që të punojnë me kapacitet të shkurtuar në mënyrë që në hapësirat për punë të mbahet distanca e nevojshme e të punësuarve njëri me tjetrin. Këtë në spinën e tyre e ndjenë qytetarët, por edhe punëtorët mediatik, të cilët duhej ta bëjnë detyrën e tyre për ta informuar opinionin me kohë për gjitha ngjarjet lidhur me virusin që e dridhi tërë botën.

Shumë prej tyre nëpërmjet përvojave të tyre na rrëfyan, se me çfarë probleme u ballafaquan për të arritur deri tek disa informacione, sa dyer të mbyllura kanë hasur dhe sa kohë u është dashur që të konfirmojnë informacionet të cilat i kanë siguruar. Të gjithë njëzëri, me të cilët kemi bashkëbiseduar, pohojnë se shumica e funksionarëve dhe institucioneve e kanë keqpërdorur pandeminë që të fshehin informacionet.

Maja Jonvanovska është gazetare e Rrjetit Laboratorik Hulumtues (IRL) dhe ajo na ka rrëfyer përvojën e saj në kryerjen e detyrave gjatë kohës së pandemisë. Sipas saj, pandemia me kovid-19 e ka ulur transparencën e institucioneve dhe ka kufizuar qasjen deri tek informacionet.

“Institucionet vazhdimisht e shfrytëzojnë pandeminë si arsyetim se informacionet nuk mund t’i dorëzojnë me kohë ose aspak nuk do t’i dorëzojnë. Po ashtu, institucionet shumë shpesh e keqpërdorin Ligjin për qasje të lirë deri tek informacionet nga karakteri publik. Gjegjësisht, presin deri në momentin e fundit që t’i dorëzojnë informacionet e kërkuara, të cilat zakonisht janë gjysmake ose kërkesa refuzohet. Dhe më pas, fillon procedurë e gjatë nëpërmjet institucioneve tjera që të sigurohen informacione që janë të rëndësishme për qytetarët, por institucionet tentojnë në çdo mënyrë të mos i japin opinionit qasje në to”, thotë Jovanovska.

Ajo nëpërmjet disa shembujve të saj, shpjegon se me çfarë është ballafaquar që të mund të informojë opinion me kohë dhe me informacione të sakta. Jovanovska madje thekson se të dhënat të cilat i ka kërkuar nëpërmjet qasjes së lirë deri tek informacionet, për të cilat afati ligjor është 30 ditë, përgjigje ka marrë pas shtatë muajve, me çka janë shkelur të gjitha afatet ligjore.

“Si shembull i institucioneve për mos-transparencë është MALMED (Agjencia për barëra), ku që në gusht IRL ka dërguar kërkesë në pajtueshmëri me Ligjin për qasje të lirë të informacioneve me karakter publik,

por përgjigje ende nuk kemi. I kemi shterur të gjitha mundësitë ligjore për përgjigje, gjegjësisht disa herë jemi ankuar deri te Agjencia për qasje të lirë, por nga MALMED nuk kemi marrë asnjë përgjigje. Përgjigjet arritën në janar të këtij viti, donë të thotë pas shtatë muajve, me çka janë shkelur të gjitha afatet ligjore, por si duket personat udhëheqës në institucionet nuk bren-gosen, por përkundrazi ata janë shumë komod, sepse dënime për ta ose nuk shqiptohen ose janë shumë të vogla”, shton Jovanovska.

Gazetarja e IRL ka vërejtje edhe për konferencat për shtyp që mbahen në Qeveri dhe thekson se parashtrimi i pyetjeve online u mundëson funksionarëve me mjeshtëri tu ikin përgjigjeve.

“Në shikim të parë janë çdo ditë dhe me kuantitet në numër të madh, por me transparencë më të ultë. Që të kuptojnë qytetarët se çfarë fshihet pas tyre, do t’i quaja

drejtime të ministrave dhe funksionarëve, do të shpjegoj se çfarë do të thotë praktikisht kjo. Pra, konferencat për shtyp dhe ngjarjet ditore i inicion qeveria, dhe kjo i bën ata në rolin e ‘redaktorit ditor’ sepse prej aty organizohet dita punuese e medimeve. Gjegjësisht pres-konferencat çdoherë janë tematike, ndërsa rrallë herë gazetarët mund të parashtrojnë pyetje jashtë temës. Gjegjësisht kjo mënyrë online e komunikimit ua lehtëson pozitën, ngase gazetari mund të parashtrojë një nën-pyetje dhe shumë lehtë mund të shmanget përgjigja e kërkuar. Nga ana tjetër kam vërejtje edhe për gazetarët ngase kjo gazetari dembelet është e mirësearchur për klikime dhe një mori lajmesh të panevojshëm, të cilat një pjesë e madhe, nuk kanë asnjë informacion që ka të bëjë me interesin publik”, precizon Jovanovska.

1.2. DUHET TË EKZISTOJË HAPËSIRË PËR KRITIKA ÇDOHERË

Ministri i shëndetësisë Venko Filipçe, në fillimin e pandemisë ishte një nga ministrat i cili nga dy tre herë në ditë paraqitej në ekranet televizive për ta qetësuar situatën, të shpjegojë se ka kapacitetet të mjaftueshme shëndetësore për të gjithë të sëmurit nga covid-19, por

edhe për atë se vendi ka kuadër të mjaftueshëm mjekësor. Tempoja e tij e punës dhe dinamika shkaktuan admirim tek pjesa më e madhe e opinionit, të cilët ministrin e shndërruan në “yll” i cili “rrezikshëm” ballafaqohet me admirim me armikun e tmerrshëm.

Por, për disa muaj situata filloi të ndryshojë. Dhe kështu nga pres-konferencat e rregullta, siç rriteshin numrat, kur arritën edhe rreth 1500 të infektuar në ditë, ministri paraqitej më rrallë, mungonin pres-konferencat, mbaheshin jo shumë shpesh, kishte informacione vetëm për numri e të infektuarve dhe të vdekurve.

Pozitive në këtë situatë ishte që të këshilltarët e punësuar përgjigjeshin me shpejtësi pyetjeve të gazetarëve, edhe pse jo çdoherë në tërësi. Shpejtësia zakonisht ka të bëjë me pyetje lidhur me informacione ditore, ndërsa për pyetjet tjera lidhur me tenderët, kompanitë dhe parat, kishte përgjigje më të ngadalshme, që deri diku është e kuptueshme, por vetëm nëse është në funksion të grumbullimit të informacioneve për të cilat nevojitet më tepër kohë.

Gjithashtu, problem ishte edhe një pjesë të profesionistëve të fushës së mjekësisë dhe shkencor nuk ishin prezent shumë në opinion.

Mirjana Mirçevksa Jovanović është gazetare në sektorin e shëndetësisë tani më disa vite dhe ajo arriti të na i tregojë të gjitha problemet me të cilat është ballafaquar për të arritur deri tek informacioni nga institucionet e vendit. Sipas saj, pandemia ka sjellë më tepër sfida për gazetarët.

“Si gazetare në shëndetësi kovid-19 është tema kryesore për çdo ditë. Një sfidë e madhe që do të lë shenjë në profesionin tim. Përvoja nga kjo pandemi tregoi se si funksionohet gjatë kohës së krizës. Për ne më me rëndësi është funksionimi i institucioneve si ata ndiko-

jnë në mënyrën e raportimit. Mund të them se një pjesë e mjekëve u përgjigjën me deklaratat dhe shpjegime me kohë. Ajo që mungonte ishte iniciativa më e madhe e kuadrit akademik, shembull profesorët. Munguan deklaratat e ASHAM-it, por edhe të profesorëve të Fakultetit të farmacisë. Komunikimi është shumë i rëndësishëm për raportim të drejtë, posaçërisht në periudhë të imunizimit të ketë informacione të sakta dhe me kohë”-shpjegon Jovanović nga Kanal5.

Ajo madje bën krahasim me mënyrën e informimit në vendet fqinje, ku pohon se kanë më tepër dëshirë për t'i informuar qytetarët e tyre për zhvillimet në shtetet e tyre.

“Për fat të keq, profesorët në Serbi me dëshirë më të madhe dhe entuziazëm kanë nevojë të shpjegojnë për rëndësinë e imunizimit” - shton gazetarja.

Sipas praktikës së deritanishme, nga ajo që mund të vërejmë, vetëm disa njerëz, të njëjtit sillen në mediat dhe ata shpjegojnë për konsumin e ilaçeve, për rrezikun nga Kovid-19, për imunizimin, për mënyrën për mbrojtje nga virusi i rrezikshëm. Të gjithë mjekët tjerë dhe ekspertët në fusha të caktuara nuk dëshirojnë të flasim për temën. Kjo nuk është për herë të parë në shtetin tonë gazetarët të ballafaqohen me situata të tilla. Njëjtë ishte edhe gjatë epidemisë së fruthit, kur asnjë nga Klinika Infektive e Shkupit, e cila duhet të jetë fortësia kryesore për sëmundjet infektive, nuk dëshironte të jep deklaratë.

1.3. TË PUNËSUARIT JANË NË IZOLIM, DO TË VONOJNË PËRGJIGJET

Pothuajse të gjithë gazetarët pa dallim në cilin sektor punojnë u ballafaquan me realitetin e trishtuar në shtet, më saktësisht me mosbashkëpunimin e një pjesë të institucioneve shtetërore, me atë që kriza e koronës ua lehtësoi edhe po aq situatën. Shembull i tillë janë gjykatat, të cilët për shkak natyrës së punës së tyre, nënkuptojnë rritje të frekuencës të punësuarve, prokurorëve, avokatëve, palëve, posaçërisht për shkak se gjykatat janë vendet ku qytetarët i realizojnë të drejtat e tyre, pa dallim nëse janë si palë, të akuzuar apo të dëmtuar.

Ekzistonte edhe ideja fillestare që gjykimet të organizohen online, në momentin kur numrat e të infektuarve ishin alarmuese, por gjykata në RMV nuk janë teknikisht të përgatitura që të zbatojnë qasje të tillë. Kështu, mbeti me të vjetër, por kjo nuk do të thotë se gazetarët të cilët me vite me radhë i ndjekin proceset gjyqësore edhe ditën edhe natën janë para gjykatave nuk u ballafaquan me transparencën e tyre, posaçërisht gjatë krizës së koronës.

“Pandemia kontribuoi për frenim të transparencës të një pjesë të institucioneve shtetërore. Ndodhte që përgjigjet e pyetjeve t’i marrë me vonese me arsyetimin se i punësuarit që i ka, ose mund t’i sigurojë të dhënat e kërkuara është në izolim për shkak të covid-19. Jo rrallë herë pandemia ishte arsye për mosbashkëpunimin.”

Më vinin shpjegime se vonesa në plotësimin e ndonjë obligimi është për shkak të pandemisë”, pohon **Elena Ivanovska Mukoska** nga televizioni Telma.

Ajo shton se, si gazetar më tepër i ndjek zhvillimet e gjyqësorit, do të thekson se Këshilli Gjyqësor nuk ka arritur të sigurojë kushte që gazetarët të mund të ndjekin seancat e tyre që janë publike.

“Që kur ka filluar pandemia, nuk mund të prezantojmë ngase salla për seancat nuk ka hapësirë të mjaftueshme që të respektohen rekomandimet shëndetësore. Këshilli gjyqësor, në bazë të principit të Komisionit për Antikorrupsion, duhet të mundësoj ndjekje online të seancave të tyre, duke patur parasysh se ky trup gjykues edhe në periudhën e ardhshme do të jetë në fokusin e opinionit. Një problem konstant tek një numër më i madh i institucioneve ligjvënëse, para dhe gjatë kohës së pandemisë është se japin përgjigje jo precize, ose shfrytëzojnë floskula se procedura është e fshehtë dhe se nuk mund të japin më tepër të dhëna”- shpjegon Mukoska.

Shumica e gazetarëve që e ndjekin sektorin e gjyqësorit pohojnë se vetëm në Gjykatën Penale në ndonjë mënyrë, edhe gjatë kohës së pandemisë, me respektim të reko-

mandimeve qeveritare, mund të ndjekin proceset gjyqësore. Në të gjitha gjykatat tjera, kjo është e pamundur ngase hapësirat janë të vogla dhe nuk ka ku të mblidhen palët, më saktësisht të akuzuarit dhe avokatët, e lërë më gazetaret.

Sipas Mukoskës, përgjigjet që më shpesh i marrin të japin përshtypje se ekzistojnë tentime që të fshihet nga opinioni puna e bërë, ose të blihet kohë shtesë.

“Në situatat të tilla, neve si gazetarë na mbetet që të shfrytëzojmë burimet tona dhe kontaktet për të dhëna që do të duhej t’i merrnim nëpërmjet kanaleve zyrtare ose pres-qendrave. Gjykata Supreme nuk e merr rolin që të jetë udhëheqës në transparencën dhe të vendos standarde për gjykatat më të ultë për transparencë ndaj mediave, ndërsa kjo shpie deri tek transparenca drejt opinionit”-, shpjegon gazetarja e Telma.

Nga ana tjetër, çdonjëra nga gjykatat ballafaqohet me problemet e brendshme gjatë kohës së pandemisë. Kështu kryetari i Gjykatës Themelore Civile, **Ilir Sulejmani**, thotë se ai në atë karrige qëndron që nga viti 2015 dhe dëshiron që të jenë më transparent por, megjithatë kushtet nuk e mundësojnë këtë.

“Ne jemi gjykata më transparente prej të gjithëve, por pandemia luajti një rol të madh në tërë këtë tregim. Për momentin më e rëndësishme është që të respektohen rekomandimet, hapësirat janë të vogla dhe nuk ka vend për ata që gjykohen dhe janë të akuzuar. Çfarë do të ndodhë nëse hyjin të gjithë gazetarët. Nëse mund të grumbullohen vetëm pesë persona, atëherë aq hyjnë në hapësirën. Nuk mund të lejojmë të hyjnë 15. Do të na ndodh klaster dhe të mbyllet tërë gjykata”, thotë Sulejmani.

Ai pranon se në adresë të tyre arrijnë ankesa për anulimin e gjykimeve por shton se nuk kanë zgjidhje.

“Në një gjykatë mund të ketë tetë paditës, ndërsa nga ana tjetër 12, dhe ku të mblidhen të gjithë. E gjithë kjo do të ketë pasoja në çfarëdo mënyre. Megjithatë, gjithçka është në drejtim të respektimit të protokolleve. Më parë kishim kolegji, dhe tani, nëse dëshirojmë të mbajmë një, duhet të shkojmë në stadium. Në kohë të pandemisë, nuk mund të jemi edhe aq transparent sa dëshirojmë, ndërsa shumica e gjykimeve anulohen për afat të logjikshëm”-, shton kryetari i Gjykatës Civile.

1.4. RAPORTIMIT NGA KUVENDI GJATË KOHËS SË PANDEMISË- “JO FALEMINDERIT”

Nuk munguan problemet gjatë kohës së pandemisë edhe në Kuvend, ku përplasjet në mes pushtetit dhe opozitës ishin në drejtim të asaj që seancat të mbahen online ose jo, duke patur parasysh faktin se kishte më tepër raste kur deputetë ishin të infektuar me kovid-19. Një pjesë e tyre nuk merrnin pjesë në seancat e kuvendit, por, megjithatë, ishte e nevojshme që të paraqiten për të votuar, ndërsa kjo ishte e vështirë ngase ishin në izolim, me qëllim që të mos e transmetojnë virusin edhe tek deputetët tjerë.

Siç ishin vendosur gjërat, shumica parlamentare ishte për online seanca, ndërsa opozita, më saktësisht grupi parlamentar i VMRO-DPMNE-së me forca të shumta insistonte që kjo të mos ndodh, duke u bazuar në nenin 69 i cili nuk e lejon atë, sepse në të shkruan se në seancat e kuvendit duhet të jetë prezent shumica e deputetëve. Në fund nuk gjetën gjuhë të përbashkët, por, nga ana tjetër gazetarët të cilët me vite i ndjekin zhvillimet në kuvend u gjetën para sfidave të reja profesionale, duke pohuar se në kohë pandemie nuk ja vlen të punohet nga hapësirat e Kuvendit, duke e pasur parasysh kushtet që ua janë “siguruar”.

“Raportim nga Kuvendi gjatë pandemisë?- Jo, faleminderit!- Kështu sigurisht do të përgjigjen të gjithë gazetarët të cilët do të marrin detyrë të tillë, duke e ditur se me çka do të ballafaqohen. Në tërë këtë proces më thjeshtë është të hysh në Kuvend si gazetar i akredituar. Më pas të gjithë korridoret të dërgojnë tek një drejtim- drejt pres qendrës. Eventualisht tek salla e kristaltë, nëse ndonjë deputetët cakton pres-konferencë në këtë sallë- e përcaktuar për kontaktet e deputetëve me deputetët. Në çdo rast, komunikimi është i njëanshëm- ne jemi aty kur ATA kanë seanca ose kur ATA kanë diçka për të na thënë. Edhe, atëherë nuk ka dalje nga sallat e pres-konferencave”-, rrëfen për përjetimet e saj në korridoret e Kuvendit, **Sonja Nikollovska** nga Tellma, e cila 25 vite punon si raportues nga Kuvendi.

Ajo shpjegon se si duket një ditë i gazetarit në korridoret e Kuvendit gjatë kohës së koronës.

“Në ato dy salla, në dispozicion i kemi tre monitorë, në të cilat bëjmë përpjekje që t'i ndjekim deputetët në foltore, përderisa ndonjë kolegë ka paraqitje drejt-përdrejt, dikush tjetër “vrapon” pas ndonjë teme, një i

tretë merret vesh për deklaratë, ndërsa gazetarët tjerë dhe kameramanët tentojnë që të mbajnë distancë. Edhe me keq është me Komisionet. Transmetim ka në Internet Explorer vetëm nga salla 'Boris Trajkovski'. Për Komisionet tjera shqyrtim të ligjeve pret nëse deputetët kanë interes të tregojnë diçka. Para asaj duhesh t'i kontaktosh me telefon ngase kontakt i rastësishëm nuk është i mundur. Këtë, mund ta bëj edhe nga zyra ime, andaj në këtë periudhë rrallë herë shkoj në Kuvend. Dhe, kur të shkojë hasi në një ose dy gazetarë që janë ati ngase kam ndonjë paraqitje drejtpërdrejt ose ndonjë takim të caktuar", shton Nikollovska.

Në mënyrë të njëjtë mendojnë edhe tjerët gazetarë të cilët me vite e ndjekin këtë sektor, kështu që shumica prej tyre aspak nuk shkojnë në Kuvend, duke patur parasysh faktin se ata mund të gjejnë mënyrë që të arrijnë deri tek informacionet e nevojshme.

Tentuam që të kontaktojmë edhe kryetarin e Kuvendit, **Talat Xhaferi**, por ai nuk u përgjigj në pyetjet tona.

1.5. PËR SHKAK SJELLJES JOPROFESIONALE NDODHTË QË TË KRIJOHEJ PANIK NË MES QYTETARËVE

Jashtë kryeqytetit, puna është edhe më e "tmerrshme". Kishte shembuj pozitiv në të cilat shumë nga kryetarët e komunave publikisht njoftuan se janë pozitiv me covid-19, por një pjesë e tyre dhe institucioneve nën udhëheqjen e tyre atë e fshihnin si sekret shtetëror. Kjo në varësi se prej cilit qytet bëhet fjalë dhe sa pushtetit lokal

është në disponim hapur dhe në mënyrë transparente të komunikojë me mediat. Shumë prej tyre tërë kohën pohonin se nuk kanë ingerenca që të miratojnë masat për parandalimin e covid-pandemisë, por thjeshtë mund të paralajmërojnë qytetarët që t'i respektojnë masat aktuale të miratuara nga qeveria.

“Duart tona janë të lidhura. Mua më mbetet vetëm të dal dhe publikisht të informojë opinionin se çfarë po ndodhë në qytetin të cilin e udhëheq, sa rate aktive ka sa të vdekur ka dhe normalisht të bëj apel që të respektohen masat. Për gjithçka tjetër dihet se kush vendos”-, thotë një kryetar komune nga lindja, i cili dëshiroi të jetë anonim.

Një pjesë e qytetarëve i akuzojnë kryetarët e komunave se edhe përkundër numrave alarmues të të infektuarve dhe të vdekurve, ata kanë bërë politikë, gjegjësisht kanë asfaltuar rrugë, ku mund të grumbullohen më tepër punëtorë. Sipas tyre, argument se autoritetet lokale mund tu ndihmojnë qytetarëve tregojnë fushatat në fillim të pandemisë, kur organizoheshin aksione dhe u dërgohej ushqim qytetarëve që ishin në vet-izolim. Po ashti, në më shumë qytetet u mbyllën këndet për lojëra të fëmijëve, gjegjësisht vendet ku grumbulloheshin më tepër fëmijë për të luajtur, ndërsa me këtë u arrit që të kontrollohet përhapja e pandemisë.

Kryetari i Velesit, **Ace Kocevski**, nga ana tjetër mburrej se komuna të cilën e udhëheq ai është një nga komunat më transparente në shtetin.

“Vite me radhë, komuna e Velesit është një nga institucionet më transparente dhe në përgjithësi institucione publike. Kemi numrin më të madh të shërbimeve digjitale dhe punojmë sipas ISO standardeve për kualitet në punën e administratës publike. Në këtë kohë- pakohë gjatë ballafaqimit me KOVID-19, kemi

pasur bashkëpunim të shkëlqyeshëm dhe së bashku kemi vepruar, jo vetëm ndërmarrjet lokale, por edhe me institucionet shëndetësore në nivel qendror, me sektorin qytetar dhe me mediat. Është për tu potencuar bashkëpunimi me NPSH Spitalin e përgjithshëm, Qendrën për Shëndet Publik, Shtëpinë e Shëndetit dhe Shoqatën e Mjekëve Amë dhe me Kryqin e Kuq. Në punën e Shtabit Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim, një kontratë të madh kishin përfaqësues të Armatës, MPB-së dhe institucionet përgjegjëse-”, thotë Kocevski.

Një pjesë e gazetarëve lokal të cilët tërë kohën e ndjekin krizën me koronavirusin në qytetet e tyre, thotë se bashkëpunimi dhe transparenca, por edhe veprimet joprofesionale në dëm të interesit publik janë pjesë nga sjellja e institucioneve përgjegjëse ndaj mediave, të cilat pandemia me koronavirusin i ka nxjerr në sipërfaqe.

*“Si punëtor media në ‘Fokus’, e cila transmeton ngjarje ditore, por edhe si banorë i rajonit të Tikveshit, që raportoj për të gjithë ngjarjet e rëndësishme në këtë rajon, që nga paraqitja e rastit të parë më kovid-19 në vend, më 26 shkurt 2020, e dija se çfarë pason. Isha rrugës kur ministri Venko Filipçe njoftoi se virusi është regjistruar në vendin tonë dhe nëpërmjet telefonit e kam ndjekur konferencën. Telefoni menjëherë filloi të cingëroj. Frika nga virusi i panjohur ishte i madh, opinioni kërkonte përgjigje, spekulime të ndryshme që nga fillimi filluan të krijojnë panik- Nëse me të vërtetë pacientja pozitive është nga Kavadari, nëse pacientët që kanë qenë në furgonin me të janë nga Negotina?- thotë gazetarja **Viki Klinçarova**.*

Ajo shton se të parën gjë të cilën e ka bërë është t'i paraqitet ministrit i cili i ka treguar se nga është pacientja, ndërsa por çdo rast të ri janë kërkuar detaje, posaçërisht kur të infektuarit janë persona të cilët kanë vende pune specifike dhe kanë qenë në kontakt me më tepër njerëz. Klinçarova pohon se ka pasur bashkëpunim shumë korrekt me Qendrën e Shëndetit Publik në Kavadar dhe me epidemiologun Riste Jovanovski, Qendrën për Shëndet Publik në Gjevgjeli dhe me drejtorin e spitalit të Kavadarit.

”

“Në muajt e parë të paraqitjes së virusit, kur u regjistruar pacienti i parë pozitiv, një person i punësuar në një fabrikë të huaj, në rajonin kishte frik se virusi është paraqitur në fabrikën ku punojnë mbi 6000 persona nga Kavadari, Negotina, Velesi, Prilepi... Qytetarët e shqetësuar kërkonin përgjigje, ndërsa deklarata e drejtoreshës që ishte aso kohe, ishte se punëtori i infektuar nuk punon në fabrikën për të cilën interesohemi, por në tjetër, ndërsa ajo refuzon që të na tregojë se ku saktësisht është i punësuar. Këto janë ato situata që shkaktojnë revolt tek populli, por edhe në mënyrë shtesë i nxisin tensionet se diçka me qëllim fshihet dhe heshtet, se ka lojëra në të situatën me pandeminë. Në vend të saj tani është emëruar një drejtoresh e re”-, ka thënë Klinçarova.

”

“Kjo është e një rëndësie të veçantë, duke e pasur parasysh atë se në Kavadar e kishim pacientit më të ri i cili humbi jetën, dhe transparenca ishte kyçe në ndërtimin e besimit të opinionit ndaj sistemit shëndetësor. Por, nuk mungonin as momentet joprofesionale në raportin institucion-media në kulmin e pandemisë botërore. Për shkak joprofessionalitetit të personave përgjegjës, ndodhte që të krijohet panik e panevojshme në mesin e popullatës” thotë Klinçarova.

Ajo si shembull negativ, e veçoi ish drejtoreshën e IPSH Veles, doktor Ivanova, e cila shumë rrallë është përgjigjur telefonatave, dhe në momentin kur e ka bërë këtë, pa nevojë ka shkakuar panik, gjë e cila e ka shqetësuar dhe irrituar opinionin.

1.6. QEVERIA DHE TRANSPARENCA GJATË KOHËS SË PANDEMISË

Në më tepër raste, qeveria deri tek të gjitha institucionet ka apeluar që të jenë transparente, me qëllim që qytetarët me kohë të informohen për të gjitha zhvillimet lidhur me covid-19. Por nga ana tjetër, edhe ata gjetën një mënyrë më të lehtë se si t'i organizojnë konferencat për shtyp në Qeveri, ndërsa ministrat përgjigjeshin në pyetjet. Kjo deri diku ishte e kënaqshme. Megjithatë nëse ndonjë pyetje, ministra të caktuar nuk dëshironin të jepnin përgjigje, me shumë mjeshtëri arrinin ta shmangnin. Këtë ua mundësonte mënyra e re e funksionimit dhe paraqitjet online, të cilat për shkak krizës me koronavirusin u bënë praktik, dhe kështu gazetarët shpesh nuk merrnin përgjigje për të gjitha pyetjet e parashtruara.

Marjan Zabërçanec, i cili është i angazhuar për marrëdhëniet me opinionin në Qeveri, thotë se nga fillimi i pandemisë, qeveria me përkushtim ka punuar me kohë dhe saktë për të informuar opinion, me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik. Ai shpjegon se ka dashur që mediat të parët t'i marrin informacionet nga institucionet me qëllim që të parandalohen lajmet e rrejshme.

“Krizë epidemiologjike është faktor kufizues që kërkonte adaptim të shpejtë të masave, dhe me këtë edhe siguri se informacionet do të arrijnë deri tek të gjithë qytetarët. Përcaktimi strategjik është që insti-

tucionet të jenë të parët që të dalin me informacione si një nga mënyra për tu penguar përhapja e lajmeve të rrejshme dhe dezinformative. Për këtë qëllim u formua ekip me detyrë që t'i koordinojë informacionet në mes shtabit të krizës, ministrisë, dhe mediave, duke siguruar informim të saktë, të përditshëm dhe të shpejtë. U përgatit protokollin për konferenca për shtyp dhe ngjarje drejtpërdrejt me media”, thotë Zabërçanec.

Sipas tij, që të arrihet transparenca e plotë, praktikohet mbajtja e konferencave për shtyp, komunikatave dhe deklaratave për media në momentin se sjelljes së vendimeve, pa dallim kushteve kohore.

“Praktika ishte njëjtë me të gjithë ministrin, përfshirë edhe kryeministrin. Informacionet primare i kemi përpunuar në gjashtë gjuhë, pjesa tjetër e komunikimit është bërë në tre gjuhë, maqedonisht, shqip dhe anglisht dhe është siguruar inkluzivitet me gjuhën e shenjave. Që të shmangen rreziqet shëndetësore, u instaluan online-mjetet për komunikim, konferencat-online dhe ndjekja digjitale e ngjarjeve. Për komunikim intensiv dhe me kohë me qytetarët rregullisht dhe shpejt u publikonin informacione në kanale të ndryshëm siç janë: Facebook, Instagram, Twitter, Viber, Youtube, ndërsa u krijuan edhe aplikacione për Android dhe IOS.

U formua edhe ueb faqe e posaçme koronavirus.gov.mk dhe në këtë kontekst u hapën linja telefonike për përkrahje psikologjike dhe informacione lidhur me masat ekonomike”, shton Zabërçanec.

Gazetarja Maja Jonvanovska na Rrjeti Hulumtues Laboratorik nuk pajtohet me të dhe nëpërmjet shembujve tregon se me çfarë ajo personalisht është ballafaquar gjatë kohës së kovid-pandemisë përderisa ka qenë duke hulumtuar tema.

“Do të theksojë një shembull personal kur nga Qeveria, gjegjësisht nga Komisioni për Emërime, i kërkova procesverbalet nga seancat e emërimit të funksionarëve, të cilat më pas konfirmohen në seancë qeveritare. Nga Komisioni për Emërime, kryetar i të cilit është zv/kryeministri Lupço Nikollovski, nuk më dorëzuan procesverbalet, me arsyetimin se procedura për emërimin e funksionarëve nuk kishte përfunduar. Kjo nuk është e vërtetë ngase që nga dita e parë kur filloi mandati i kësaj qeverie, pothuajse nuk ka seancë në të cilën nuk zgjidhen nga dhjetë drejtorë, anëtarë të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës”, thotë Jovanovska.

Ajo nuk është e vetmja e cila është ballafaquar me këto probleme duke e punuar punën e saj, gjegjësisht informacioni të arrijë sa më shpejtë tek qytetarët. Shumë prej gazetarëve u gjetën përballë sfidave të reja profesionale në karrierat e tyre, sfida që deri më tani nuk i kanë patur.

Si për traditë, me disa prej tyre me të cilët kemi biseduar dëshironin të mbesin anonim duke pohuar se do të kenë probleme në mediat ku punojnë nëse e kritikojnë punën e qeverisë.

“Mund të them lirisht se për dallim nga Qeveria e VMRO-DPMNE-së, për të cilën gjithçka ishte sekret shtetëror, kjo qeveri është dukshëm më transparente, por, megjithatë, edhe ata kanë lëshime. Është fakt se disa gjëra është më mirë të mbulohen, se sa të zbulohen, por poenta është të zgjidhet problemi. Për drejtorët të mos flasim, mendojë se ata janë më pak transparent në punën e tyre”, pohon gazetarja e cila dëshiron të jetë anonime.

1.7. REKOMANDIME PËR TRANSPARENCË MË TË MADHE

Kjo pandemi, e cila zgjat qe një vit, i vuri në test të gjithë palët e përfshira, si gazetarët, ashtu edhe institucionet, të cilët u detyruan ditë dhe natë, njëra palë të jep informacione, ndërsa të tjerët t'i plasojnë në opinion. Nuk munguan as lajmet e rrejshme, dhe dezinformacionet me të cilat u stërmbushën në pjesë e mediave, për arsye të njohura për ta.

Në Maqedoni punët shkuar deri aty që në fund të majit, para ndërtesës së qeverisë u mbajt një protestë kundër rrjetit 5G, koronavirusit dhe vaksinimit të obligueshëm. Në atë protestë u thanë shumë informacione të rrejshme, akuza të pabaza dhe dezinformacione në tentim të minimizohet serioziteti i sëmundjes, që mund të sjellë pasoja serioze në tërë shoqërinë. Organizatorët në deklaratat e tyre e quanin pandeminë si të rrejshme, ndërsa si “argumentim” për pohimin e tillë, i shpjegonin sëmundjet shoqëruese, gjegjësisht sëmundjet kronike që i kanë pasur ata që kanë vdekur nga koronavirusi.

Kështu që, në përgjithësi, kovid-pandemia, e tregoi fytyrën e vërtetë të institucioneve dhe të punonjësve mediatik, të cilët, duke dashur që në mënyrë profesionale ta bëjnë punën e tyre, shumë shpesh kritikoheshin se me qëllim ngrenë panik dhe i frikësojnë qytetarët. Çdo qeveri në këtë shtet, pa dallim se nga cila parti vjen, duhet të kuptojë se puna e gazetarëve është në mënyrë

kritike të ndjek dhe të vëzhgojë punën e tyre, dhe të mos i lavdërojnë për projektet që për çdo ditë i paralajmërojnë. Posaçërisht kur bëhet fjalë për paralajmërim, ndërsa rrallë herë vije deri tek realizimi. Çdo gazetar duhet me kohë dhe në mënyrë transparente ta informoj opinionin duke e patur parasysh se interesi publik është para se gjithash. Në situatën posaçërisht me kovid-19, qytetarët janë më të rëndësishëm për shkak se janë më tepër të tanguar. Fakt është se nuk kemi të drejtë të kritikojmë se Ministria e Shëndetësisë për çdo ditë na ka informuar për numrin e të infektuarve të ri dhe të vdekurve, kur rregullisht në e-postën e gazetarëve arrijnë raportet aty.

Por nga ana tjetër observimi kritik i punës së të gjithëve, përfshirë këtu edhe të autoriteteve shëndetësore është e patjetërsueshme. Nuk do të thotë nëse është pandemi, të gjithë duhet të pajtohen me atë se çfarë thonë institucionet përgjegjëse me qëllim që të mos bëhet panik. Askush nuk mund të fsheh nga opinioni, nëse në institucionet publike shëndetësore ka mungesë të personelit mjekësor, posaçërisht kur kjo u bë alarmante gjatë pandemisë, kur shumica e punëtorëve shëndetësor, duke mos mundur ta durojnë presionin në të cilin punojnë, shkuan në spitalet private, ku normalisht kanë kushte më të mira për punë dhe rroga më të mëdha.

Përderisa tek ne në shtet askush nuk kupton se nuk është

punë e gazetarëve ta lavdërojnë qeverinë dhe punën e saj, por të gjejnë gabimet dhe zëshëm të tregojnë me qëllim që të përmirësohen gjërat, atëherë kemi problem serioz. Ndodh, që shumë nga ministrat personalisht të fyejnë ndonjë shkrim gazetaresk ku kritikohet puna e ministrit të cilën e udhëheqin dhe të ndërpresin çfarëdolloj komunikimi me atë gazetar. Për këtë lirshëm mund të themi se çdo kush duhet ta shohë punën e vet, ndërsa kjo nënkupton se drejtorët, deputetët dhe ministrat duhet të jenë transparent dhe llogaridhënës për punën ndaj gazetarëve nëse dëshirojnë të jetojnë, siç thonë, në një shoqëri e njëjtë për të gjithë.

Në tërë këtë kovid-pandemi, jeta e punonjësve mediatik u vendos në rrezik për shkak virusit të tmerrshëm, dhe të mos flasim sa prej tyre, madje edhe redaksi të tëra ishin

“viktima” vetëm për shkak e kanë kryer punën e tyre. Gazetarët nga ana tjetër, u ekspozuan në rrezik për shkak shëndetit të tyre, ndërsa nga ana tjetër, në disa situata duhej të luftonin me mos transparencën e disa funksionarëve, për shkak se nuk u konvenon ajo që është e shkruar. Sipas përvojës së deritanishme, mund të konkludojmë se qeveria mund të apelojë vazhdimisht për transparencë dhe llogaridhënie, në fund, gjithçka varet individualisht nga çdo funksionarë. Fakt është se një pjesë e tyre rregullisht japin informacione, por një pjesë e tyre tregojnë nivel të ultë të tolerancës, të ofenduar nga mediat për kritikën e bërë për punën e tyre, Të gjithë pajtohemi se duhet të bëhet betejë e përbashkët kundër koronavirusit, por jo me çdo çmim. Çdokush duhet ta bëjë punën e vet, edhe funksionarët edhe punëtorët mediatik.

Elena Ivanovska-Mukoska: Gjykata Penale është e hapur për sigurimin e informacioneve

Elena Ivanovska-Mukoska, gazetarja e cila e ndjek gjyqësorin thotë se sipas përvojës së saj Gjykata Penale është në përgjithësi e hapur për marrjen e informacioneve.

“Duke e patur parasysh se lëndët më të mëdha gjyqësore për të cilat ka interes në opinion zhvillohen në këtë gjykatë, mbetet dhe sfida e përditshme të organizohet ndjekja e gjykimit sipas protokolleve. Salla e madhe i plotëson kushtet, në to, gazetarët janë të ndarë me paravan prej xhami, ndërsa ka edhe dritare

për ajrosje, por një pjesë e sallave nuk kanë dritare dhe janë më të vogla. Indeksi i perceptimit për korrupsion të Transparency International për korrupsionin, në të cilin Maqedonia është në vendin më të keq në dekadat e fundit, alarmon se pikërisht sundimi i së drejtës është pika e dobët, ndërsa e thekson nevojën për transparencë më të madhe të institucioneve. Kjo është edhe një tregues se urgjentisht janë të nevojshme ndryshime thelbësore dhe rezultate, dhe jo vetë përpjekje deklarative”, thotë Mukoska.

Sonja Nikollovska: Gjatë pandemisë më lehtë raportohet nga Kuvendi, nuk duhet as të ngrihem nga kompjuteri

Gazetarja Sonja Nikollovska nga Tellma pohon se në tërë golgotën kuvendore gjatë pandemisë, pika e vetme e ndritur ishin brifingjet me kryetarin e Kuvendit, **Talat Xhaferi**.

“Një herë një muaj mund t’ia parashtrojmë pyetjet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Por, pa përgjigje mbetet pyetja: deri kur kështu? Shumë vështire shkon bindja me:

- ▶ Nuk dua të lëshojë inserte të njëjta me të gjitha mediat gjatë çdo raportim për seancat e kuvendit,
- ▶ Nuk kam dëshirë kualiteti i fotografisë të ketë standard si VXS nga koha e fillimeve të mia si gazetare
- ▶ Nuk dua të gjithë mediat t’i përpunojnë të njëjtat tema të Kuvendit ngase vetëm ato janë të pashme atë ditë,
- ▶ Nuk dëshirojë sigurimi ta pengojë çdo hap që e bëjë jashtë Pres-qendrës.
- ▶ Nuk dëshirojë me orë t’i pres deputetët të më tregojnë se çfarë punojnë
- ▶ Nuk dua të kem qasje në seancat vetëm nga transmetimi i Kanalit të Kuvendit

- ▶ Nuk dua të besojë se 2 mijë euro në vit janë shumë para që Kuvendit të ketë kanalin në Youtube, si institucionet tjera të rëndësishme në shtet
- ▶ Nuk dëshirojë të besojë se seancat-online do të jenë të pakapshme deri në pensionimin tim, ndërsa shumica parlamentare do ta llogaris si sukses Rregulloren, i cili do të lejojë votim-online për deputetët e sëmurë.

Pasojat janë evidente: kuvendi është atraktiv vetëm për shkak përplasjes verbale në mes pushtetit dhe opozitës. Përmbajtja dhe pajtueshmëria për projektet ligjore u është lëshuar qeverisë dhe partive, ndërsa përforcohet përshtypja se deputetët nuk punojë sa duhet për pagën që e marrin.

Dhe, kështu, në pyetjen se si rrjedh raportimi nga Kuvendi gjatë kohës së pandemisë, mund të them: “Lehtë, nuk duhet as që çohem nga kompjuteri im në TV Telma” shton Nikollovska.

Viki Klinçarova: Isha në shënjestër se po bëj panik, më pas më kërkonin falje

Viki Klinçarova thotë se pandemia ka dëshmuar se punëtorët mediatik ku do qofshin ata në shtetin tonë, kanë rëndësi të madhe dhe përgjegjësi për informim të saktë dhe me kohë të opinionit.

“Personalisht unë në disa raste kamë qenë në shënjestër të akuzave nga persona që besojnë teorive të ndryshme konspirative se ky është një virus i shpikur dhe se gazetarët janë të paguar për të krijuar panik. Por, kur në valën e

vjeshtës, numri i të infektuarve dukshëm u rritë dhe kërkohet një shtretër i lirë në spitalet, ndodhi ajo që disa nga ata që më akuzonin me zë, të më thonë se kanë gabuar, ndërsa gabimin e kanë vërejtur pasi ata, ose ndonjë i afërm i

tyre është infektuar. Do ta theksojë bashkëpunimin me ministrin Filipçe i cili çdoherë përgjigjet në thirrje ose mesazh dhe bën përpjekje që problemet e qytetarëve të zgjidhen”, shton Klinçarova.

Marjan Zabërçanec: Po bëjmë gjithçka që qytetarët të jenë të informuar me kohë

Zabërçanec pohon se për qasje më të lehtë në informatat kanë formuar seksione të veçanta për covid-19 në faqen e qeverisë vlada.mk/covid-19, në të cilën mund të gjenden vendimet nga seancat, rregulloret dhe të gjitha informacionet e rëndësishme lidhur me ballafaqimin me covid-19.

“Sfidë tërë këto muaj janë ngjarjet publike jashtë media-qendrës. Që të pengohen rreziqet, në përpikshmëri janë respektuar protokollat shëndetësore, ndërsa sipas nevojë janë siguruar edhe pajisje mbrojtëse. Dërgohet

pako mediale me foto, video dhe përmbajtje me tekst si informacione nga ngjarjet. Seancat e qeverisë mbahen online. Në mesin e sfidave të menaxhimit janë edhe udhëtimet zyrtare jashtë vendit. Për këtë qëllim nëpërmjet furnizimit publik është nënshkruar marrëveshje me laboratorin për PCR testim të punësuarve në çdo kohë. Procesi i punës është në mënyrë të tillë i organizuar që të mbrohen punëtorët me praktikum të punës nga shtëpia”, shton Zabërçanec.

Gjykatësit me maska, palët online

Vetëm një muaj nga fillimi i pandemisë me koronavirusin në vendin tonë, për herë të parë në Gjykatën Themelore të Kavadarit diskutimet për katër lëndët gjyqësore u mbajtën me online-gjykim, bën të ditur aso kohe nga gjykata, Në mënyrë virtuale ishin prezent përfaqësues nga Prokuroria Themelore Publike në Kavadar, nga Komitetit ndërkomunal për punë sociale, si dhe avokatët përfaqësues. Siç informuan atëherë nga Gjykata, seancat janë mbajtur në platformën “Microsoft times”.

“Në atë mënyrë gjykata dhe të gjithë pjesëmarrësit tjerë në procedurë i ndërmorën dhe i siguruan të gjitha masat për preventivë, me sigurimin e dimensionit social gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme, me qëllim që pa ndërprerë të mbahen seancat dhe ndërmarrjen e veprimeve gjatë procedurave gjyqësore”, njoftuan në prill nga Gjykata Themelore e Kavadarit.

II. SI PANDEMIJA NDIKOI MBI BOTËN MEDIATIKE “PRAPRA PERDES”

U ndryshua mënyra e sigurimit të informacioneve, burimet e informacioneve në mënyrë të ndryshme komunikojnë me gazetarët gjatë pandemisë. Çdo informacion në kohë pandemie dihet të kontrollohet dhe filtrohet për shkak rrezikut që në të të futet helmi i dezinformatave dhe gjysmë informacioneve. Në këtë arenë për saktësi dhe me kohë, përpos interesit publik gazetaret dhe punëtorët mediatik duhej të luftojnë edhe për kushte për mbrojtje të shëndetit personal, rroga dinjitoze dhe paqe psikologjike.

Shkruan: Miroslava Burns

Pandemia e KOVID-19 kërcënoi që të ndryshojë krejtësisht dukjen e gazetarisë por nuk arriti. Gazetarët me kohë u përshtatën të pashmangshmes- në kohë të pandemisë, informacioni mund të gjendet dhe të plasohet në mënyrë profesionale, por në mënyrë, siç janë kontaktet me burimet do të ulen dhe zëvendësohen me telefon dhe video-lidhje, brifingjet në zyrat nuk do të paraqiten si diçka të obligueshme, por do të kërkohen metoda alternative për sigurimin e informacioneve. Në sfidën e tillë, më vështirë e kanë për tu përshtatur televizionet. Natyra e tyre imponon video-materiale, deklarata nga personat, të cilët më shpesh incizohen personalisht ose me ndjekjen e ngjarjeve për informimin e opinionit. Edhe shoqatat profesionale u kyçën me resurset e tyre në drejtim të mbrojtjes së fuqisë së shtatë.

SHGM dhe Këshilli për Etik në Mediat, që më 18 mars, në fillimin e pandemisë përpunuan udhëzime për raportim të sigurt dhe profesional për koronavirusin. Pjesa e dytë e publikimit ka të bëjë më atë si gazetarët dhe punëtorët mediatik ta mbrojnë veten por edhe kolegët e tyre gjatë kohës kur i kryejnë obligimet e punës. Gazetarëve, punonjësve mediatik, redaktorëve përgjegjës, menaxhmenteve dhe atyre që organizojnë takime me gazetarët e kanë për detyrim tu përmbahen rekomandimeve të dhëna nga institucionet e shtetit, si Ministria e Shëndetësisë, Instituti për Shëndet Publik, Qendrat për Shëndet Publik, Komisionit për Mbrojtje të Popullatës nga Sëmundjet Infektive, MPB-së, presidentit të shteti dhe shoqatat profesionale, të cilat, rekomandimet e tyre i përgatisin në pajtueshmëri me organizatat ndërkombëtare.

Në mesin e masave standarde për mbrojtje të cila SHGM dhe Këshilli për Etik ua ka rekomanduar gazetarëve dhe punonjësve mediatik, ishte larja e rregullt e duarve, higjiena personale, mbajtja e distancës të paktën një metër, mbajtja e pajisjes mbrojtëse personale, pastrim dhe dezinfektim i pajisjes të cilat punojnë si, kamerat, mikrofonat, fotoaparartet dhe hapësirat për punë. Drejtuesve të medimeve u ishte udhëzuar që të lirojnë nga obligimet e punës dhe t'i dërgojnë në vetizolim ose të dakordohen nëse dëshirojnë të punojnë nga shtëpia, gazetarët dhe punonjësit mediatik të cilët kanë ndonjë nga sëmundjet kronike të publikuara nga listën e Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gazetarët më në moshë dhe punonjësit media, ata kanë ndonjë sëmundje kronike, ndërsa nuk është në listën e Ministrisë së Shëndetësisë së RMV-së, si dhe gazetarët shtatzënë dhe punëtorët mediatik të cilat në mënyrë aktive shkojnë në punë sipas vendimit të tyre, megjithatë janë pjesë e njerëzve me rrezik të lartë dhe për këtë shkak punëdhënësi duhet t'ju jep detyra të cilat do të mund t'i punojnë në kushte shtëpiake, ose kryesisht detyra nga redaksia.

Gazetarët që raportuan nga tereni u rekomandohej të kërkojnë informacione nga organizatori nëse në hapësirat (nëse është e mbyllur) ka të siguar pjesë të posaçme për mediat dhe mundësi për distancë prej 1 metra në mes ekipeve gazetareske, posaçërisht në mes kamera-manëve.

"Gjatë raportimit nga vendet me më tepër njerëz, mbani distancë prej të paktën tre deri në pesë metra nga grupi, nëse ka nevojë të afroheni për incizim dhe fotografim. Gjithashtu kërkoni mbrojtje nga shfrytëzimi i një mikrofoni kur parashtroni pyetje. Nëse kot protokolle nuk janë lëshuar sipas standardeve, kërkoni nga organizatorët që t'ua sigurojnë këtë, ose të ju japin qasje online deri tek ngjarja (nëse kanë të organizuar) prej ku do të mund t'i siguroni deklaratat. Mund të kërkoni edhe nga personi i angazhuar për marrëdhënie me opinionin dhe mediat, nëse mundet që pyetjet t'i parashtroni në mënyrë elektronike dhe ato të jenë të lexuara në mënyrë precize siç janë shkruar për personin me interes për mediat, ndërsa më pas të merrni transkripto nga përgjigjet në pyetjet e parashtruara", theksohet në drejtimet e shoqatave profesionale.

Trajçe Ilievski, kameraman në MTV, duke dhënë një retrospektivë të pandemisë, e cila filloi në mars të vitit 2020, tha se në fillim masat janë respektuar, por në disa raste kameramanët duhej të reagonin ndaj mosrespektimit të protokolleve në ngjarjet e organizuara nga institucionet shtetërore.

"Nuk u respektonte distanca në ngjarje të caktuara, ku më shumë kameramanë vinin për të mbuluar ngjarjen. Ne reaguam përmes SHGM-së dhe këto mangësi u korrigjuan. Gjatë zgjedhjeve, për shembull, disa parti politike na ftonin të filmojmë në dhoma të vogla. U krijua një situatë e keqe ku ata mendonin se ne duam t'i bojkotojmë ato ngjarje, ndërsa ne në fakt

vetëm mbronim veten dhe të afërmit tanë. Në shtator, ose tetor, kur filloi me punë, vet parlamenti filloi të mos i respektojë masat. Ata jepnin deklaratat në qendrën e shtypit, në sallë, në vend që të jepnin deklaratat në vend të hapur. Pas reagimit tonë, ata filluan të zbrisnin poshtë. Duhej ne të reagojmë, që vetë deputetët të respektojnë masat që ata janë të detyruar të respektojnë. Pastaj disa institucione filluan të na japin insertet dhe video-materialet e tyre për të na mbrojtur. Unë jam një nga njëzet punonjësit mediatik që u sëmurën nga Kovid-19 me një pamje klinike mesatare dhe për shkak të kësaj ne duhej të izolohehemi. Unë jam i kënaqur me atë se si reagoi punëdhënësi, nuk kishte asnjë problem. Ne e dinim të infektuarin primar, menjëherë bëmë test, u paraqita te përgjegjësi im dhe nuk kishte asnjë problem. Isha në izolim për njëzet ditë dhe sipas informatave, as pacientët e tjerë në mesin e punonjësve mediatik nuk kanë pasur probleme me menaxhmentin. Maskat dhe dezinfektuesit ende i kemi të siguruar nga redaksia, ndërsa ne si kameramanë kemi dezinfektues në çdo cep," tha Ilievski.

Kjo ankesë nuk ishte e vetmja në pandeminë. Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik, më 5 tetor vitin e kaluar ka apeluar që institucionet të sigurojnë kushte për informim të sigurt gjatë kohës së pandemisë me koronavirusin, për shkak se deri tek ata kanë reaguar më tepër anëtarë për mënyrën se si është organizuar një ngjarje me rastin e Ditës Botërore të Mësimdhënësve.

“Ngjarja që u mbajt në sheshin e qytetit ishte i hapur me instalime të çantave shkollore në karriget, të cilat në mënyrë simbolike tregonin mirënjohje për mësuesdhënësit. Me arsyetimin se kjo është instalim, punonjësve mediatik nuk ju lejua të ulen në karriget. Për këtë shkak, gazetarët dhe kameramanët qëndronin pranë njëri me tjetrin, pa asnjë mundësi për distancën e nevojshme, sipas protokolleve shëndetësore për mbrojtje nga koronavirusi. Potencojmë se kjo nuk është rasti i parë, përkundrazi, pothuajse për çdo ditë ministrit, por edhe disa organet të bashkësive lokale organizojnë konferenca për shtyp ose deklarata në të cilat, edhe pse në të hapur, nuk respektohen masat për mbrojtje nga koronavirusi, andaj gazetarët dhe punonjësit mediatik janë të vendosur në kushte joadekuate që t’i kryejnë detyrat e tyre”, thanë nga Sindikata, duke i thirrur kolegët e tyre, që pa dallim interesit publik për ngjarjen, në të ardhmen t’i braktisin ngjarjet e tilla, nëse vlerësojnë se protokollat shëndetësore dhe nëse organizatori, edhe pse i është thënë, nuk i siguron kushtet e nevojshme për mbrojtje të shëndetit.

Në fillim të pandemisë, edhe qeveria informonte që në mars se duke patur parasysh situatën e jashtëzakonshme, konferencat për shtyp do të realizohen vetëm online, pa prezencë të gazetarëve dhe kameramanëve në media qendren në Qeveri.

Pyetjet për pres-konferencat, gjatë ditës mund të dërgoheshin në portparol@vlada.gov.mk dhe në e-mail adresën e zëdhënësit/personit për marrëdhënie me publikun në ministrinë përkatëse, me theksimin e medias prej ku vjen pyetja dhe me shenjën për konferencë për shtyp, gjegjësisht për cilin ministër/re (përfaqësues i institucionit) bëhet fjalë.

Qeveria siguron edhe video me rezolucion të lartë për shkarkim të materialeve në kanal në Youtube. SHGM dhe Këshilli për Etik nga ana tjetër rekomanduan që ekipet e gazetarëve ose udhëheqësit e mediave në mes vete të dakordohen të dërgojnë vetëm një ekip për të gjitha mediat, kur bëhet fjalë për ngjarje me interes publik lidhur me gjendjen, pas çka gazetari nga ai ekip do t’i dorëzojë pyetjet e të gjitha medimeve dhe do t’i shpërndajë materialet e incizuara.

Rekomandimet për raportime nga tereni, kishin të bëjnë me atë që gjatë incizimit dhe paraqitjes drejtpërdrejt, largësia minimale në mes atyre që janë prezent të jetë një metër. Në spitalet, si vende me rrezik të lartë për infeksion, gazetarët bartnin dorëza dhe këshillohej që pajisjet të mos lihen në tokë.

2.1. REKOMANDIME PËR PUNË NË REDAKSITË

Mediumet u ristrukturuan, ku ishte e mundur, ndërsa ekipet gazetareske ndërroheshin në grupe, që të mos vije në situatë të gjithë nga redaksia të sëmurën dhe të detyrohen të shkojnë në izolim. Kjo në një farë mënyre ishte e njëjtë me sistemet e rotacionit të cilat i praktikojnë personeli mjekësor në spitalet.

Ky rekomandim ishte e një rëndësie të veçantë për servis publik, i cili në një nga skenarët më konservatorë duhet të kenë në dispozicion ekupe për informimin e opinionit. Të punësuarit që mundeshin t'i kryejnë obligimet e punës nga shtëpia pa asnjë pengesë, ishin të nxitur nga drejtoritë që ta bëjnë këtë.

Ishte rekomanduar që takimet e punës dhe kolegjiu- met të mos mbahen ose të reduktohen ose të kërkohen mënyra alternative të komunikimit nëpërmjet video-konferencave, me telefon ose në të hapur, ku ata që ishin prezent mund të kenë një metër distancë.

Pamela Cilakov, gazetare dhe korrespondente nga Vele- si për RTMV 1, thotë se, përpos punëtorëve shëndetësor, policët dhe gazetarët ishin të parët të goditur nga pan- demia e kovid-19, e cila e kaploi tërë botën dhe u bë temë që mori hov dhe është prezentë në përditshmërinë tonë.

“Përpos korrespondencës për shërbimin kombëtar, për mua si gazetare e re, më saktësisht analist politik në fushën e ekonomisë, të raportoj për temën e shën- detësisë ishte një sfidë e madhe. Edhe mjekët dhe personat shkencor nuk e dinin se për çfarë saktësisht bëhet fjalë, ndërsa ne kemi një ngarkesë të madhe gjithë atë ta transmetojmë me vetëdije dhe me përg- jegjësi para syve të opinionit, të informojmë qytetarët, dhe, në fund, të qetësojmë, të mbetemi të vetëdijshëm dhe të apelojmë për mënyrën e re të jetës, edhe pse në vete bartnim shumë frikë, por, megjithatë, tentonim ta fshehim. Qyteti im Velezi, të cilin e njoh si një nga më të frekuentuarit, gjatë orës policore, në rrugë ishim vetëm unë dhe kameramani im, bënim gjiro rreth qyte- tit ngase kishim paraqitje të drejtpërdrejt për ditarin qendror të RTVM-së, dhe ajo është pamje që asnjëherë nuk do ta harrojë. Qyteti im ishte aq i zbrazët dhe i pashpirt. Depresion, panik, frikë, dhe ankth i madh ishte tek çdo njeri. Sa i përket ndryshimit të punës, më së shumti do të isha ndalur tek raporti me bash- këbiseduesit, sepse përderisa sundon frika dhe pani- ku, njerëzit ndryshojnë, ndërsa kjo pasqyrohet edhe në raportin e tyre ndaj neve. Në fillim, kujtoj se asnjë nga personat kompetent në të cilët shpresonim se do të na

ndihmojnë dhe dinë më tepër se qytetarët e thjeshtë për temën e kovid-19, nuk dëshironin të japin deklarata drejtpërdrejt, por kjo u bënte me video-lidhje, andaj raportimet ishin më tepër amatore”, tha Cilakov.

Sa i përket mbrojtjes personale, praktika bartjes së maskave dhe dezinfektuesve u përëditshmëri.

“Pa maskë as që mendoja të shkojë në terren, mjet për dezinfektim vazhdimisht shfrytëzonim dhe shihnim të kemi sa më pak kontakte në hapësira të mbyllura, ndërsa deklaratat ndonjëherë i kishim edhe nëpërmjet lidhjes telefonike. Të gjithë raportuesit e dimë ndjenjën se dëshirojmë të dukemi sa më profesional në televizion, por në këtë kohë-pakohë, mënyra e punës tërësisht u ndryshua, më të rëndësishëm ishin qytetarët dhe informimi me kohë dhe i saktë, me qëllim që të shpëtohet jeta e dikujt. Periudha më e vështirë për mua ishte në kohën e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, kur duhej të raportoj nga të gjitha qytetet e rajonit të Vardarit. Edhe pse kisha maskë mbrojtës, megjithatë kisha frikë se mund të sëmurëm nga kovid-19. Mund të veçojë edhe një ngjarje. Në nëntor kur numri i të sëmurëve në qytet rritej, ndërsa numri i të hospitalizuarve ishte rreth 90, kjo ishte periudha kur të gjithë kishim frikë. Shumë më gëzon fakti se qytetarët më pyesnin cili është mendimi im për këtë temë, por për shkak se nuk jam ekspert, këtë ua lija personave kompetent. Megjithatë, menjëherë i qetësoja duke u thënë se shpresojmë që sa më shpejtë të mbarojë e gjithë kjo”, ka shtuar ajo.

Tamara Gërçarovska, gazetare në televizionin Telma, thotë se shkalla e sigurisë dhe mbrojtjes së gazetarëve në redaksitë, në kushte të pandemisë, më lehtë mund të krahasohet me tentimin që të mos të të futet ujë në gojë përderisa je duke bërë dush. E thënë thjeshtë, sa të mundohesh, nuk mund të jesh 100% i sigurt se e ki arritur atë.

“Kështu pas një viti punë në kushte të pandemisë, mund të konstatojë se në redaksitë ose të paktën në redaksinë ku punojë unë, zbatohen masat për mbrojtje të gazetarëve dhe punonjësve mediatik, nëpërmjet dezinfektimit të përditshëm të hapësirave për punë, ndarjes së punës në grupe, mbajtjes së maskave me rreptësi, por edhe vet natyra e punës së gazetarëve posaçërisht në televizionet e krijon perceptimin ku “furret uji”, ndërsa kjo janë daljet e patjetërsueshme në teren shkuarja në ngjarje, por edhe vet procesi i punës në redaksitë, ku jemi të detyruar të komunikojmë dhe punojmë me më tepër njerëz”, shpjegon Gërçarovska.

Por nëse mediat e panë rrezikun të cilin e bartë pandemia për funksionimin e tyre, për shkak edhe ndërmorën masa për mbrojtje të gazetarëve në redaksitë, përshtypja e saj është se institucionet në mbrojtjen u qasën me një standard të dyfishtë, më shumë për të veten se sa për gazetarët.

"Nga njëra anë, për shkak të pandemisë në 90 për qind u shfuqizua mbajtja e pres-konferencave në ambiente të mbyllura me prezencë të gazetarëve, madje edhe atje ku ka kushte për këtë, si dhe incizimi i ngjarjeve në ambient të mbyllur. Brifingjet dhe kontaktet drejtpërdrejt u shndërruan në minimum, është kufizuar edhe qasja në institucionet. Paralelisht me këtë vazhdon mbajtja dhe dhënia e deklaratave të funksionarëve në ambient të hapur, ku gazetarët dhe kameramanët zakonisht nuk kanë kushte adekuate për punë dhe nuk mund në përpikshmëri të mbajnë distancën dhe mund të thuhet marrin frymë në fytyrën e njëri tjetrit në tentim për ta incizuar deklaratën ose për të parashtruar pyetjen. Në kushte të tilla gazetarët dhe kameramanët, me maska në fytyrë dhe me mjet dezinfektues në xhep, e vetmja gjë që ju mbetet është që të shpresojnë se ata që i kanë për rreth të mos kenë covid-19. Por, pandemia, përpos kushteve për punë, e ndryshoi edhe mënyrën e punës të gazetarëve, posaçërisht në televizionet. I ndau në grupe dhe bëri që të përzihen sektorët. Në mënyrë të detyrueshme i futi në botën e teknologjive të reja komunikuese, kamerat dhe mikrofonat ua ndryshoi me Zoom dhe Skype, brifingjet me kafe me biseda telefonike, i mësoi të shfrytëzojnë programe për incizim online nga kompjuterët. I detyroi të pajtohen me faktin se konferencat-online varen nga lidhja e internetit dhe na butoni "mute" i administratorit. Në vend kamerës së lirë tani më shpesh kërkojnë termine të lira për incizim në kompjuter, ndërsa i avancojnë edhe shkathtësitë për improvizim, posaçërisht kur në Wetransfer, institucionet u dërgojnë nga 20

sekonda inserte, për kronik prej dy minutave. Por siç solli kufizimi, pengesa, nervozë, në zbatimin e mënyrës së re të funksionimit të gazetarisë dhe redaksive, pandemia poashtu ka përforcuar solidaritetin mes gazetarëve për tejkalimin e atyre sfidave, që për mua është momenti i vetëm i ndritshëm në vitin e covid-gazetarisë", thotë Gërçaroska.

Qeveria, nga ana tjetër përgatiti protokoll të detajuar për mbajtjen e ngjarjeve me prezencë të mediave në kushte të pandemisë të shkaktuar nga koronavirusi.

Ai përmban dy pjesë, drejtime të përgjithshme, të cilat kanë të bëjnë me të gjitha ngjarjet publike, në të cilat organizatori parashikon edhe prezencë të mediave dhe pjesë të posaçme, e cila ka të bëjë me ngjarje që janë nën organizimin e institucioneve qeveritare.

Sipas këtij protokollit ngjarjet, për të cilat është e paraparë prezencë të mediave, rekomandohet të mbahen në ambient të hapur, nëse e lejojnë këtë kushtet klimatike, sipas këtyre masave: të gjithë të pranishmit detyrimisht dhe tërë kohën të mbajnë maska mbrojtëse, sigurohet zërimi që të mos ketë grumbullim të mikrofonave, sigurohen dy mikrofone, njëri vendoset para folësit, ndërsa tjetri është për punëtorët mediatik të cilët parashetrojnë pyetje, mikrofonat dezinfektohen para dhe pas mbarimit të ngjarjes, gjegjësisht gjatë ndryshimit të folësit.

Në mes atyre që janë të pranishëm sigurohet distancë më e madhe e mundshme (të paktën dy metra) dhe një-

kohësisht gazetarët dhe kameramanët, por njëkohësisht në mes gazetarëve, kameramanëve dhe atyre që mbajnë fjalime rregullohet hapësira që të mos ketë grupime dhe të mos shkelet distanca e nevojshme.

Nëse kushtet klimatike dhe hapësira nuk lejojnë mbajtjen e ngjarjeve me prezencë të gazetarëve, qeveria rekomandoi ato të mbahen me mjetet për kyçje të drejtpërdrejt, ku organizatori është i obliguar të sigurojë kontroll teknik gjysmë ore para fillimit të ngjarjes në mënyrë që të sigurojë lidhje funksionale për punëtorët mediatik. Në pres konferencat e organizuara në Qeveri, nga ana e ministrit të Shëndetësisë, në disa raste gazetarët u ankuan se nuk mund të parashtronë më shumë se një pyetje dhe se nuk është mundësuar kanal për komunikim të dyanshëm, sepse menjëherë pas përgjigjes së pyetjes, nuk u është mundësuar që të parashtronë pyetje shtesë. Pres konferencat për pandeminë kanë zgjatur shumë, të paktën një orë, ndonjëherë dy orë, kur ishin prezent më tepër funksionarë, që paraqiste sfidë që të grumbullohen poentat kryesore dhe të kthehet vëmendja e opinionit nga poentat kryesore.

Drejtori i "Sloboden Peçat" Miroslav Jovanović, thotë se me komunikatat e para dhe drejtimet e dhëna nga Ministria e Shëndetësisë, në lidhje me covid-19, "Sloboden Peçat", u vendos në mbrojtje të vërtetës dhe informacionit me kohë dhe të saktë në funksion të qytetarëve.

"Sloboden Peçat" si burim i informacioneve çdoherë ka shfrytëzuar burime të besueshme nga organet qeveritare, OBSH, por edhe nga trupa tjerë referues kredibil nga vendet e huaja, duke luftuar çdo ditë me lajmet e rrejshme dhe dezinformata nga çfarëdolloji. Në ditët e para të pandemisë, gazeta në kushtet të kovidit pa pengesë vazhdoi ta kryejë obligimin shoqëror, informim të qytetarëve, ndërsa njëkohësisht duke u udhëhequr nga rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë, Komisionit për Sëmundje Infektive dhe OBSH e ka riorganizuar punën e vet, duke mbajtur llogari edhe për shëndetin e punëtorëve. Me zbatimin e IT teknologjive më të reja, pjesës më të madhe të punëtorëve në "Sloboden Peçat" u është mundësuar që të punojnë njëjtë me efikasitet dhe me përgjegjësi nga shtëpia, duke shmangur kontaktet fizike në zyrat e gazetës. Si një nga rojtarët e të mirës publike dhe shëndetit në vendin tonë, në periudhën e kaluar "Sloboden Peçat" ka demantuar shumë lajme, gjysmë informacione, ka zbërthyer teori të ndryshme konspirative, ndërsa me këtë u ndihmoi qytetarëve që të kthejnë besimin në sistemin shëndetësor në shtet. "Sloboden Peçat" ka parashtruar dhe do të vazhdojë të parashtror pyetje që janë të pakëndshme për pushtetarët, me qëllim që qytetarët më në fund ta kenë vendin kryesor në shoqërinë tonë. Madje, edhe slogani jonë "në anën e popullit" për çdo ditë duhet dëshmuar dhe konfirmuar", thotë Jovanović.

Gjatë kohës së pandemisë ekzistonin edhe raste të izoluar kur gazetarëve u ishte pamundësuar që ta kryejnë punën e tyre në rrethin e spitalit "8-shtatori". Për këtë shkak, përfaqësues të SHGM-së, SPGPM dhe KEMM u takuan me ministrin për shëndetësi, Venko Filipçe, i cili konfirmoi se nuk ekziston vendim formal me të cilin mund të përku-fizohet hapësira publike në të cilin punojnë gazetarët para objekteve shëndetësore. Ai shtoi se ata mund dhe

duhet pa pengesë të incizojnë në të gjitha hapësirat publike para objekteve spitalore në drejtim të raportimit profesional në lidhje me pandeminë.

Shoqatat e esnafëve, nga ana tjetër, theksuan se gazetarët raportimet e tyre duhet t'i bëjnë në përputhje me standardet etike, duke respektuar privatësinë e pacientëve dhe familjarëve të tyre, në përputhje me interesin publik.

2.2. TRAZIRAT FINANCIARE PËR GAZETARËT DHE MEDIAT

Që në mars, shoqatat profesionale filluan të apelojnë qeveria të gjej mekanizma që tu ndihmojë gazetarëve dhe mediave që ta tejkalojnë krizën pa pasoja të rënda, ngase ekzistonte rrezik i madh punëtorët mediatik dhe gazetarët të largohen nga puna, më cka do të vihej në pikëpyetje raportimi i tyre kredibil dhe objektiv, e nevojshme në kushte të rritjes së dezinformatave dhe gjysmë-informacioneve të cilat paraqiteshin në hapësirën mediatike. Mediumet funksiononin nga një anë të ballafaquar me sfidën e rrezikut financiar, ndërsa nga ana tjetër të ballafaquar me përgjegjësinë e madhe për informim të drejtë të opinionit.

Në qershor të vitit të kaluar Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik bëri një hulumtim mes kolegëve,

prej ku doli se gazetarët dhe punëtorët mediatik kanë frikë nga koronavirusi, por edhe nga fakti se mund ta humbin punën. Hulumtimi u bë me 150 të anketuar, prej të cilëve 62 për qind theksuan se mënyra e re e punës u ndikon në shëndetin mental, 22 për qind deklaruan se pronarët nuk u kanë siguruar pajisje mbrojtëse, 45 për qind thanë se kanë pasur nevojë për pajisje mbrojtëse shtesë ose në momentin e hulumtimit ose në të ardhmen, ndërsa 48 për qind kanë pasur nevojë për përkrahje psikologjike. 25 për qind e tyre u shprehën se problemi më i madh për raportimin për covid-19 ka qenë transparenca e vogël e institucioneve.

Se punëtorët mediatik nuk janë imun ndaj koronavirusit tregojnë edhe faktet se vetëm deri 1 korrik vitin e kaluar

janë evidentuar, dy raste të vdekjes mes punëtorëve mediatik si pasojë e kovid-19. Bëhet fjalë për dyzet e katër vjetarin Bekim Bajramovski nga Labënishti, i punësuar si teknik në televizionin Spektra dhe 51-vjeçarin Shenol Ahmeti nga TVM.

“Dhjetëra gazetarë dhe punonjës mediatik ishin pozitiv me kovid-19, ndërsa një pjesë u dërguan në vetizolim për shkak të kontakteve me persona të infektuar gjatë kryerjes së detyrave. Në atë periudhë me thyerje të drejtave të punëtorëve, pronarët me vet-dëshirë kanë vendosur të mos paguajnë pushim mjekësor për 37 anketues tanë, ose 24 për qind nga të anketuarit. Njëqind të anketuar janë përgjigjur se pushimi mjekësor u është paguar”, qëndron në hulumtimin e Sindikatës.

Shqetëson fakti se madje 30 për qind nga të anketuarit janë përgjigjur se njohin dikë që ka mbetur pa punë gjatë kohës së pandemisë. Shtatëmbëdhjetë për qind nga punëtorët mediatik janë përgjigjur se u është ulur rroga.

Sindikata dhe SHGM ashpër reagues ndaj vendimit që të largohen nga puna pesë gazetarë, dy të punësuar në kohë të caktuar, ndërsa një pjesë të mos u vazhdohen marrëveshjet për honorarë, duke u frikësuar dhe paralajmëruar për domino efekt i cili mund të krijohet edhe në redaksitë tjera.

“Qeveria u pajtua të sjellë rregullore me fuqi ligjore, me të cilat gazetarëve do tu paguhen kontributet për sigurim social dhe shëndetësor, me kusht të mos u ulen pagat dhe të kthehen në nivelin fillestar. Supozimi ishte se për këtë shkak nuk kishte shumë ankesa për përjashtime, edhe pse rregullorja ishte për periudhë prej tre muajve”, thotë Darko Duridanski nga Sindikata e gazetarëve.

Çfarë u miratua si masë për zbutjen e pasojave nga kriza dhe ruajtjen e funksionimit të dinjitetshëm të mediave? Gjatë kohës së pandemisë mediat mund të shfrytëzonin masat për zbutjen e pasojave ekonomike për pagesat në vlerë neto prej 14.500 denarë. Me propozim të Agjencisë për Komunikime Elektronike, u soll rregullore me të cilat radiot ishin të liruar nga pagesa për shfrytëzimin e radio-frekuencave ndaj AEK-it.

Televizionet që kishin leje për emetim nëpërmjet multipleksit tokësor, u liruan nga pagesa e kompensimit për vitin 2020, ndërsa shteti u obligua se do t'i paguaj shpenzimet. U subvencionuan edhe kontributet për sigurim të detyrueshëm për të punësuarit në mediat që kanë raportuar për kovid-19.

2.3. MITET PËR KOVID-19 NË MËNYRË SHITESË U KRIJUAN PROBLEME GAZETAVE

Mediat rajonale, në fillim të pandemisë, që në mars, filluan të raportojnë për një trend të pa arsyetueshëm dhe sjellje prej paniku të lexuesve të cilët kanë ndërprerë ose më rrallë kanë filluar të blejnë gazeta ngase janë frikësuar se mund të infektohen me koronavirus nëpërmjet sipërfaqes së gazetës. Kështu agjencia “Anadollu” raportoi se në Ankara, numri i gazetave të shitura në mars ka shënuar rënie, ngase njerëzit së pari nuk kanë dalë nga shtëpia dhe e kanë respektuar karantinën, dhe për shkak se kanë menduar se mund të infektohen me koronavirus nëpërmjet gazetës.

Mundësia që një person i infektuar që transmetojë sëmundjen nëpërmjet të mirave komerciale është e ulët dhe rreziku të infektoheni me virusin që shkakton koronë nëpërmjet mjetit që ka lëvizur, transportuar dhe i ekspozuar në temperatura të ndryshme poashtu është i vogël, ka informuar Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Sipas “Anadollut”, lexuesit u transferuan më tepër në platformat e internetit, ndërsa lexuesit besnik, të cilët kanë

blerë madje nga dy gazeta në ditë, në Turqi kanë hequr dorë nga kjo kënaqësi ngase janë informuar keq për atë se si përhapet koronavirusi.

Servisi britanik “BBC” në qershor vitin e kaluar ka raportuar për sfidat që është dashur të ballafaqohen gazetarët e redaksive të sportit. Me anulimin e pothuajse të gjitha ngjarjeve sportive në këtë periudhë, u paraqit edhe problemi se si të mbushen faqet e sportit kur agjenda sportive ishte minimizuar.

Në vend të garave sportive, të cilat nuk ishin të shpeshta dhe nuk ishin në fokusin e vëmendjes, vëmendja u kthye kah tregimet për përkujdesje shoqërore të individëve në pandeminë dhe bashkëndjenja me ata që humbin anëtarët e familjes.

2.4. ÇFARË MËSUAM NGA PANDEMIJA?

Siç institucionet e sistemit ngadalë filluan të kthehen në normalitet dhe të funksionojnë me intensitet lartë-poshtë të pandalshëm, siç filluan të mbaheshin seancat e Kuvendit, seancat në këshillat komunal dhe në organet e tjera të bashkësive lokale, si dhe në agjencitë në vend, ashtu filloi edhe të normalizohet agjenda e gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Tani më nuk raportohet vetëm për koronavirusin, por vëmendje qendrore marrin edhe ngjarjet që kanë të bëjnë me problemet e përditshme të qytetarëve, informacione nga organet shtetërore të cilat nuk janë të lidhura thjeshtë vetëm me pandeminë, por edhe dukuri tjera shoqëroro-sociale.

Padyshim se koronavirusi dhe pandemia ende shkaktojnë ndjenja për rrezik nga infektimi tek gazetarët, të cilët edhe më tej i praktikojnë masat mbrojtëse, ndërsa në ato redaksi ku është e mundur punohet nga shtëpia me ndihmën e mjeteve teknologjike dhe pa prezencë fizike në tërë redaksinë në hapësirat e mediumit.

Mjetet për grumbullimin e informacioneve në internet si dhe rrjetet sociale mbeten një platformë e sigurt për komunikim me burimet, në pritje të fundit final të pandemisë, kur redaksitë do të mund të vazhdojnë me funksionimin normal.

Cilakov: edhe pse në vete kishim frikë, megjithatë tentonim ta fshihnim

Pamela Cilakov, gazetare dhe korrespondente nga Velesi për RTMV 1, thotë se, përpos punëtorëve shëndetësor, policët dhe gazetarët ishin të parët të goditur nga pandemia e kovid-19, e cila e kaploi tërë botën dhe u bë temë që mori hov dhe është prezentë në përditshmërinë tonë.

“Përpos korrespondencës për shërbimin kombëtar, për mua si gazetare e re, më saktësisht analist politik në fushën e ekonomisë, të raportoj për temën e shëndetësisë ishte një sfidë e madhe. Edhe mjekët dhe personat shkencor nuk e dinin se për çfarë saktësisht bëhet fjalë, ndërsa ne kemi një ngarkesë të madhe gjithë atë ta transmetojmë

me vetëdije dhe me përgjegjësi para syve të opinionit, të informojmë qytetarët, dhe, në fund, të qetësojmë, të mbetemi të vetëdijshëm dhe të apelojmë për mënyrën e re të jetës, edhe pse në vete bartnim shumë frikë, por, megjithatë, tentonim ta fshehim. Qyteti im Velesi, të cilin e njoh si një nga më të frekuentuarit, gjatë orës policore, në rrugë ishim vetëm unë dhe kameramani im, bënim gjiro rreth qytetit ngase kishim paraqitje të drejtpërdrejt për ditarin qendror të RTVM-së, dhe ajo është pamje që asnjëherë nuk do ta harrojë. Qyteti im ishte aq i zbrazët dhe i pashpirt. Depresion, panik, frikë, dhe ankth i madh ishte tek çdo njeri.”

Ilievski: Miratonin masa, ndërsa nuk i respektonin çdoherë

Trajçe Ilievski, kameraman i RTVM-së, duke dhënë një retrospektiv për pandeminë që filloi në mars 2020, thotë se në fillim masat janë respektuar, por se, në shumë raste, kameramanët është dashur të reagojnë për mos respektim të protokolleve për ngjarje të organizuara nga institucionet.

"Nuk respektohej distanca në ndonjë ngjarje më të rëndësishme, ku më tepër kameraman vinin për ta transmetuar

ngjarjen. Kemi reaguar nëpërmjet SHGM-së dhe u korrigjuan. Gjatë kohës së zgjedhjeve, shembull, disa parti politike në ftonin për të incizuar në dhoma të vogla. Arritëm në një situatë që të krijohet fotografi e keqe dhe të mendojnë se jemi duke i bojkotuar, ndërsa ne vetëm e mbronin veten tonë dhe më të afërmit tanë. Në shtator, gjegjësisht në tetor, kur filloi me punë kuvendi, vet kuvendi filloi të mos i respektojë masat. Jepnin deklarata në pres-qendrat, në vend që poshtë në të hapur."

Gërçaroska: online pres-konferencat varen nga internet-lidhja dhe nga butoni "mute" e administratorit

"Por nëse mediat e panë rrezikun të cilin e bartë pandemia për funksionimin e tyre, për shkak edhe ndërmorën masa për mbrojtje të gazetarëve në redaksitë, përshtypja e saj është se institucionet në mbrojtjen u qasën me një standard të dyfishtë, më shumë për të veten se sa për gazetarët," thotë gazetarja e TV Telma, Tamara Gërçarovska.

"Por, pandemia, përpos kushteve për punë, e ndryshoi edhe mënyrën e punës të gazetarëve, posaçërisht në televizionet. I ndau në grupe dhe bëri që të përzihen sektorët. Në mënyrë të detyrueshme i futi në botën e teknologjive të reja komunikuese, kamerat dhe mikrofonat ua ndryshoi me Zoom dhe Skype, brifingjet me kafe me biseda telefonike, i mësoi të shfrytëzojnë programe për incizim online

nga kompjuterët. I detyroi të pajtohen me faktin se konferencat-online varen nga lidhja e internetit dhe na butoni "mute" i administratorit.

Në vend kamerës së lirë tani më shpesh kërkohen termine të lira për incizim në kompjuter, ndërsa i avancojnë edhe shkathtësitë për improvizim, posaçërisht kur në Wetransfer, institucionet u dërgojnë nga 20 sekonda inserte, për kronik prej dy minutave. Por siç solli kufizimi, pengesa, nervozë, në zbatimin e mënyrës së re të funksionimit të gazetarisë dhe redaksive, pandemia poashtu ka përforcuar solidaritetin mes gazetarëve për tejkalimin e atyre sfidave, që për mua është momenti i vetëm i ndritshëm në vitin e kovid-gazetarisë", thotë Gërçarovska.

2.5. REKOMANDIME: VAKSINIM KUNDËR KOVID DHE KUNDËR DEZINFORMATAVE?

Para më shumë se një viti, dilema e vetme etike e gazetarëve ishte lidhur me zbulimin e informacioneve lidhur me llojin bazik të koronavirusit, tentimet për tu mbrojtur të infektuarit nga stigmatizimi, mënyra e transmetimit të sëmundjes dhe ngjashëm. Sot për gjithë këto çështje, ende nuk ka përgjigje të qarta, por dilemat në aspekt të sodit më tepër janë në një aspekt tjetër të virusit- imunizimi. Vaksinat kundër koronavirusit dhe gjitha pyetjet lidhur me to, sot janë tema kryesore e gazetarëve për hulumtim analiza dhe debate. Ekzistojnë shumë aspekte që shqyrtohen në këtë tematik, duke filluar nga prodhimi dhe furnizimi me vaksinat, suksesi i tyre dhe efektet anësore, deri tek teoritë e konspiracionit

dhe tregimet për përfitimet e mëdha që bëhen në dëm të qytetarëve. Nënkuptohej të gjitha janë legjitime, por, gjithashtu, duhet të dihet se në luftën për informacion që e ndjek temën e vaksinimit, e vetmja që mund të pësojë është e vërteta, dhe duke u nisur që këtu do të rikujtojmë në pjesë të drejtimeve për raportim të sigurt dhe profesional për koronavirusin që e kanë përgatitur Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) dhe Këshilli për Etikë të Mediave në Maqedoni (KEMM) në interes të informimit më të mirë të opinionit dhe gazetarë dhe punëtorë mediatik gjatë kryerjes së obligimeve profesionale të përditshme.

Edhe pse tematika është pak më ndryshe se një vit më parë, megjithatë këto disa rregulla universale janë një udhëzues i mirë për raportimin për kovid-19 dhe për vaksinimin e cila këtë vit do të jetë e kruciale në betejën kundër virusit të rrezikshëm.

DREJTIME PËR RAPORTIME PROFESIONALE

- ▶ **Kontroll i mirë i informacioneve**
- ▶ **Vazhdimësi në informimin**
- ▶ **Qetësimin e tensioneve dhe ofrim të zgjidhjes**
- ▶ **Shfrytëzim të burimeve adekuate të informacioneve**
- ▶ **Shfrytëzim të titujve adekuat**
- ▶ **Të shfrytëzohen shpjegime të thjeshta**
- ▶ **Përdorim të duhur të fjalorit, pa senzacionalizëm**
- ▶ **Inkuadrimi i storjeve në kontekstin e duhur**
- ▶ **Përdorimi i kujdesshëm i vizualizimit**
- ▶ **Roli aktiv në zbulimin e dezinformatave**



Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë